

# ASPEKTE TË LEGJISLACIONIT PENAL NË FUSHËN E LËNDËVE NARKOTIKE GJATË PERIUDHËS SË TRANZICIONIT NË SHQIPËRI

**Prof.As. Dr. Fatos GJATA\***

**Abstrakt:** *Ky studim është pjesë e një punimi që fokusohet në evidentimin e veprave penale të kryera në fushën e lëndëve narkotike si dhe në gjetjen e rrugëve për minimizimin e rreziqeve, pasojë e përdorimit të tyre. Ai bazohet në politikën penale që përfshin fushën juridiko-penale të pasqyruar në ndryshimet e ndodhura në drejtim të përmirësimit të legjislacionit.*

*Studimi përmbledh legjislacionin penal në vitet 1990-1995, ndryshimet që ka pësuar legjislacioni penal pas vitit 2001 si dhe masat ligjore të marra në fushën e trafikimit të substancave narkotike.*

**Fjalët kyç:** *Vepër penale në fushën e narkotikëve; mbajtje, shitje, përdorim, trafikim dhe kultivim i lëndëve narkotike, “substancë narkotike ose psikotrope”, “trafik i paligjshëm”.*

## 1. Hyrje

Ndryshimet e thella që përkojnë me vendosjen e demokracisë pas viteve '90 në vendin tonë sollën si pasojë përhapjen në masë të plagëve sociale të tilla si kriminaliteti, droga, prostitucioni, etj. Në varësi të kushteve të krijuara, lindi nevoja e ndryshimeve në fushën juridike nëpërmjet përmirësimit të legjislacionit dhe në lidhje me kriminalitetin dhe veprat penale të kryera në fushën e lëndëve narkotike. Pikërisht për të evidentuar veprat penale të kryera në këtë fushë si dhe për të gjetur rrugët e minimizimit të rreziqeve, pasojë e përdorimit dhe trafikimit të lëndëve narkotike u ndërmor dhe ky studim, që shtrihet në periudhën e viteve 1996-2001 dhe i fokusuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Rrethit të Tiranës.

Materiali është i ndarë në dy pjesë që trajtojnë veprat penale në fushën e narkotikëve nga këndvështrimi juridiko- penal, kriminologjik, bazuar në politikën penale si dhe në politikën parandaluese të veprave penale të kryera në fushën e trafikimit. Për këtë qëllim është shfrytëzuar një fond literature nga autorë të vendit që kanë dhënë një ndihmesë të konsiderueshme në këtë fushë, e gërshetuar kjo me autorë të tjerë të vendit dhe të huaj që përkojnë me fushat e mjekësisë, sociologjisë dhe psikologjisë për të pasqyruar në gjithë kompleksitetin e tij fenomenin e drogës si dhe vendosjen e piketave ku mund të

---

\* Pedagog në Akademinë e Edukimit Fizik dhe Sporteve. Departamenti i Shkencave të Edukimit Profesional. Grup-lëndët e Shkencave Sociale e Humane.

mbështetet e gjithë puna e organizmave të specializuar shtetërorë, por dhe e mbarë shoqërisë për marrjen e masave parandaluese të krimit në këtë fushë.

Të dhënat e këtij studimi janë bazuar në një skedë të bërë për këtë qëllim, e gërshetuar dhe me statistikat e nxjerra nga Ministria e Rendit Publik dhe PNUD., e cila përmban elementë të tillë që lidhen me numrin e përgjithshëm të personave të gjykuar gjatë kësaj periudhe: me gjininë e tyre; statusin civil dhe social; prejardhjen (nga zonat urbane apo rurale); veprat penale për të cilat akuzohen personat (mbajtës, trafikues, kultivues të lëndëve narkotike); nëse janë përsëritës për veprën penale të kryer; nëse vepra penale është kryer vetëm apo në bashkëpunim; nëse janë autorë, viktimë apo bëjnë pjesë në të dyja kategoritë njëherësh; llojin dhe sasinë e lëndëve narkotike që ata kanë përdorur, trafikuar apo kultivuar si dhe llojet dhe masat e dënimit që janë dhënë për ta, në varësi të veprës penale për të cilën akuzohen.

Në tërësi i gjithë materiali synon të krijojë një tablo të qartë mbi veprat penale të kryera në fushën e lëndëve narkotike dhe të gjykuara në Gjykatën e Rrethit të Tiranës, si dhe të vendosë piketa orientuese në drejtim të parandalimit të krimit në këtë fushë, të gërshetuara me masa sociale që përfshijnë organet shtetërore, organizatat jo qeveritare, strukturat ligjore (Prokurorinë, Gjykatën, Policinë), familjen, shkollën, medien dhe mbarë opinionin publik.

## **2. Një vështrim juridiko-penal i veprave penale në fushën e narkotikëve**

Fitorja e demokracisë pas viteve '90 shënoi jo vetëm një hapje të plotë të Shqipërisë ndaj vendeve të civilizuara perëndimore, por në kushtet e ekonomisë së tregut, të lëvizjes së lirë të njerëzve dhe të përshpejtimin të ritmeve të jetës u krijua një ambient i favorshëm për konfrontimin e shoqërisë civile me probleme sociale, që tashmë janë evidente në të gjitha shoqëritë e civilizuara. Niveli i lartë i papunësisë, veçanërisht tek rinia, i llogaritur në 36% në vitin 1998; niveli i lartë i ndërprerjes së studimeve (shkolla e lartë 1,9%, shkolla e mesme 46,7% dhe shkolla tetëvjeçare 51,4%<sup>2</sup> (1) gjatë këtij viti, duhet të merren në konsideratë si faktorë potencialë të riskut lidhur me trafikun e drogës dhe përdorimin e saj. Nga ana tjetër, evident paraqitet krimi i organizuar duke sjellë violencë, pasiguri dhe frikë, ku si pasojë situata social-ekonomike keqësohet së tepërmi. Kjo situatë acarohet edhe më, po të kemi parasysh krijimin e një rrjeti të ri të shpërndarësve të drogës (i lidhur ngushtë me vende të tilla si Turqia, Greqia, Maqedonia, Bullgaria dhe Mafia Italiane) duke krijuar një treg të paligjshëm droge në vend. Studime dhe përpjekje për vlerësime të madhësisë së fenomenit ekzistojnë edhe përmes iniciativave të ndryshme të ndërmarra dhe nga OJQ-të. Por studime të tilla duhet të jenë më të thella me një shtrirje më të madhe në mënyrë që të bëhen pjesë e strategjisë kombëtare për të përballuar sfidat e drogës dhe të problemeve që ajo gjeneron.

<sup>2</sup> "Droga dhe të rinjtë":16.

Një rol të rëndësishëm kanë luajtur të dhënat që burojnë nga qendrat që merren direkt me trajtimin e individëve, të cilët kanë krijuar probleme me përdorimin e substancave abuzive të drogës, duke treguar se janë elementë thelbësorë për të gjykuar mbi natyrën e fenomenit dhe shtrirjen e elementëve përbërës që kanë të bëjnë me individin, drogën, rrethanat sociale dhe problemet biologjike, psikologjike dhe sociale o të kemi parasysh krijimin e një rrjeti të ri të shpërndarësve të drogës (i lidhur ngushtë me vende të tilla si Turqia, Greqia, Maqedonia, Bullgaria dhe Mafia Italiane) duke krijuar një treg të paligjshëm droge në vend.

Aktualisht, përdoren metoda nga më të ndryshmet në përpjekje për të vlerësuar sa më realisht shtrirjen e këtij fenomeni me dimensionet dhe elementet tepër komplekse të tij. Treguesit janë të ndryshëm; ata zgjidhen të tillë që të identifikojnë dhe të paraqesin elementët më thelbësorë, që janë shtylla, mbi të cilat ngrihet piramida gjigante e drogës. Ato reflektojnë konceptet, ideologjitë, pikëpamjet shkencore dhe sidomos qasjet dhe strategjitë në parandalimin dhe përballimin e problemit kompleks të drogës. Studime dhe përpjekje për vlerësime të madhësisë së fenomenit ekzistojnë edhe përmes iniciativave të ndryshme të ndërmarra dhe nga OJQ-të. Por studime të tilla duhet të jenë më të thella me një shtrirje më të madhe në mënyrë që të bëhen pjesë e strategjisë kombëtare për të përballuar sfidat e drogës dhe të problemeve që ajo gjeneron.

Një rol të rëndësishëm kanë luajtur të dhënat që burojnë nga qendrat që merren direkt me trajtimin e individëve, të cilët kanë krijuar probleme me përdorimin e substancave abuzive të drogës, duke treguar se janë elementë thelbësorë për të gjykuar mbi natyrën e fenomenit dhe shtrirjen e elementëve përbërës që kanë të bëjnë me individin, drogën, rrethanat sociale dhe problemet biologjike, psikologjike dhe sociale. Në politikën kombëtare mbi drogën, rol të rëndësishëm ka luajtur krijimi i Komitetit Kombëtar për luftën kundër Drogës në vitin 1996 i drejtuar nga zëvendëskryeministri dhe i përbërë nga ministrat e të gjitha ministrive të përfshirë në luftën kundër drogës.<sup>3</sup>

Me të njëjtin vendim krijohet dhe Qendra Kombëtare e Sistemit të Informacionit mbi Drogën. Në këtë kuadër, në vitin 1998 krijohet Këshilli Kombëtar Teknik Ndërdisciplinor mbi Drogën. I gjithë ky organizëm në luftën kundër trafikut të narkotikëve do të pasohet nga një sërë ndryshimesh të akteve ligjore të shprehura në Kodin Penal të vitit 1995<sup>4</sup>, në Kodin Penal të Azhornuar<sup>5</sup> si dhe në një sërë vendimesh të pasqyruara në Fletoret e ndryshme Zyrtare, të cilat kanë të bëjnë me intensifikimin e luftës kundër trafikut të

<sup>3</sup> Vendim i qeverisë nr.412, datë 20 maj 1996.

<sup>4</sup> Kodin Penal të vitit 1995.

<sup>5</sup> Kodin Penal të Azhornuar 1999.

drogës dhe në marrjen e masave ligjore gjithnjë e më shtrënguese për autorët që kryejnë vepra penale në këtë fushë.

### 3. Legjislacioni penal në vitet 1990-1995

Në kushtet e reja politike shoqërore u hodh ideja e përqendrimit në disa drejtime kryesore për të përmirësuar Kodin Penal. Karakteristikat kryesore të Kodit të Ri Penal,<sup>6</sup> cili hyri në fuqi më 1.06.1995, shërbyen si burim kryesor për mendimin teorik në fushën penale. Në Kodin e Ri Penal të vitit 1995, interes të veçantë paraqesin nenet që trajtojnë problemet e kultivimit, prodhimit dhe nxitjes për shitjen e lëndëve narkotike dhe problemin e drogës, që përbën dhe thelbin e këtij studimi. Në nenin 283 të Kodit Penal<sup>7</sup> është shprehur qartë përgjegjësia që mban individi i cili implikohet në përgatitjen, shpërndarjen dhe shitjen e lëndëve narkotike.

Po kështu neni 284 i këtij kodi<sup>8</sup> trajton problemin e kultivimit të bimëve narkotike. Dhe në këtë nen të kodit është përcaktuar ligjërisht dënimi për individët që kultivojnë dhe tregtojnë bimë narkotike. Në nenin 285 të Kodit Penal<sup>9</sup> dënohet dhe mbajtja e pajisjeve për prodhimin e narkotikëve. Dënim me burgim përcaktohet dhe për individin që nxit marrjen dhe përdorimin e drogës. Neni 286 i këtij Kodi<sup>10</sup> (5.4) ka të bëjë me përcaktimin e dënimit për “Nxitjen dhe përdorimin e drogës”.

Kuadri i legjislacionit penal ka ndryshuar dhe me daljen e Kodit Penal të Azhornuar.<sup>11</sup> Midis një sërë ndryshimesh të bëra, dallojmë disa shtojca (nene të veçanta) dhe në fushën e trafikut të narkotikëve. Po t’i referohemi nenit 283/a<sup>12</sup> do të shohim se ka një zgjerim të gamës së personave që për shkak të detyrës të administrimit të substancave të tilla, në

<sup>6</sup> Kodi i Ri Penal – 01.06.1995.

<sup>7</sup> Neni 283 i K.P: “Prodhimi, përzierja, përgatitja, shpërndarja, mbajtja, ofrimi për shitje, shpërndarja në çdo mënyrë, transportimi i çdo lloj droge ose substanca psikotrope në kundërshtim me dispozitat ligjore, dënohen me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet. Organizimi, drejtimi apo financimi i kësaj veprimtarie, dënohen me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet”.

<sup>8</sup> Neni 284 i K.P: “Kultivimi i bimëve apo tregtimi i farërave që shërbejnë për prodhim të drogës narkotike apo substancave psikotrope pa leje, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet. Organizimi, drejtimi apo financimi i kësaj veprimtarie, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet”.

<sup>9</sup> Neni 285 i K.P : “Mbajtja, prodhimi, transferimi, shpërndarja e pajisjeve, materialeve apo e substancave që janë përdorur ose do të përdoren për përdorimin e drogës narkotike apo substancave psikotrope, dënohen me burgim gjer në pesë vjet”.

<sup>10</sup> Neni 286 i K.P: “Nxitja e të tjerëve për përdorimin e drogës narkotike ose të substancave psikotrope, apo injektimi i tyre pa pëlqimin e të dëmtuarit, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet”. “Kur nxitja apo injektimi i detyruar bëhet ndaj fëmijëve apo në institucione penale, shkollore, sportive apo të çdo veprimtarie tjetër shoqërore, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në pesëmbëdhjetë vjet”.

<sup>11</sup> Kodi Penal i Azhornuar i vitit 1999.

<sup>12</sup> Kodi Penal i Azhornuar: 82 Neni 283/a: “Krijimi nga ana e personave, që për shkak të detyrës administrojnë substanca të tilla, i lehtësirave për marrjen e përdorimin e narkotikëve në kundërshtim me dispozitat përkatëse ligjore dënohet deri në 10 vjet burgim”.

rastet kur abuzohet me to i nënshtrohen ndjekjes penale. Neni 284/a<sup>13</sup> i këtij Kodi, ka lidhje me organizmin dhe drejtimin e organizatave kriminale. Dhe në këtë rast kemi një shtojcë në fushën e narkotikëve, ku dënimi përfshin jo vetëm individin, por dhe organizata kriminale të ngritura për këtë qëllim si dhe implikimin në të të personave me funksione shtetërore.

Intensifikimi në fushën e narkotikëve vihet re midis të tjerash dhe në nenin shtojcë<sup>14</sup> të Kodit Penal (të azhornuar), ku krijohen lehtësira për personat që kanë qenë të implikuar, por që bashkëpunojnë dhe ndihmojnë organet e ndjekjes penale në luftën dhe zbulimin e personave që kryejnë krime të tilla. Në kuadrin e ndryshimit të legjislacionit penal në vitet 1990 – 1995, midis një sërë artikujsh dhe kumtesash, spikat dhe botimi i Pjesës së Posaçme të tekstit të së drejtës penale.

Qëllimi i tij është sqarimi nga pikëpamja teorike e kuptimit dhe përmbajtjes së normave juridike të cilat parashikojnë vepra penale, si dhe llojin dhe masat e dënimit për cilindo prej tyre. Duke qenë se Pjesa e Posaçme mbështetet në Dispozitat e Pjesës së Përgjithshme të Kodit Penal të cilat përmbajnë parimet dhe institucionet kryesore, lindi nevoja e përgatitjes së Komentarit të Kodit Penal - Pjesa e Përgjithshme.<sup>15</sup> Komentari i Kodit Penal - Pjesa e Përgjithshme ka rëndësi teorike dhe praktike pasi sqaron nocionet, parimet dhe institutet e së drejtës penale të Republikës së Shqipërisë, të sanksionuara në Kodin e Ri Penal. Komentari u ndërta sipas modelit të Kodeve Penale të shteteve demokratike dhe në të sqarohen të gjitha institutet e së drejtës penale, ligji penal, përgjegjësia penale, bashkëpunimi, dënimet, caktimi i dënimit, alternativat e dënimit me burgim, të ndjekjes penale, të dënimeve dhe mosekzekutimit të tyre.

Duke qenë se praktika gjyqësore është ende e kufizuar, me mjaft interes të karakterit teorik paraqiten dhe problemet e krimit të organizuar në Shqipëri, veçanërisht në ekonomi.<sup>16</sup> Gjatë kësaj periudhe janë ndërmarrë një sërë studimesh dhe janë botuar

<sup>13</sup> K.P.A:83. Neni 284/a: “Organizimi, drejtimi dhe financimi i organizatave kriminale me qëllim kultivimin, fabrikimin ose trafikun e paligjshëm të narkotikëve dënohet me burgim nga 10 deri në 20 vjet. Krijimi i kushteve apo lehtësirave për veprimtari të tilla nga persona me funksione shtetërore, dënohet me burgim nga 5 deri në 15 vjet”

<sup>14</sup> K.P.A:83 Neni 284/b: “Personi i arrestuar ose i dënuar për njërin nga veprat penale që kanë lidhje me trafikun e narkotikëve,.....ose për vepra penale të kryera nga organizata kriminale, që bashkëpunon dhe ndihmon organet e ndjekjes penale në luftën kundër tyre ose, sipas rastit, në zbulimin e personave të tjerë që kryejnë krime të tilla, nuk mund të dënohet më tepër se gjysma e dënimit të parashikuar për veprën e kryer prej tij. Në raste të veçanta, ku konkurrojnë dhe rrethana konkurruese në favor të tij, ky person mund të përjashtohet nga dënimi”.

<sup>15</sup> Komentari i Kodit Penal (Pjesa e Përgjithshme) u morr përsipër dhe u botua nga një grup autorësh - I.Elezi, M.Haxhia, S.Kaçupi.

<sup>16</sup> Bejko.Sh. “Analizë juridiko-penale e krimit të organizuar” Në të bëhet një analizë juridiko – penale, madje dhe kriminologjike e krimit të organizuar, bazuar në Kodin e Ri Penal. Përshkrimin e

artikuj interesantë në lidhje me fushën penale, ku spikasin tema të tilla që përkojnë me “Probleme të Pjesës së Përgjithshme të Kodit Penal Ushtarak”; “Krimi i organizuar ekonomik dhe lufta kundër tij”; “Kryerja e veprave penale nga të miturit dhe pozita e tyre në legjislacionin penal”, etj.

#### 4. Ndryshimet e ligjit penal pas vitit 2001

Legjislacioni penal ka pësuar ndryshime të herë pas hershme gjatë dhjetëvjeçarit të fundit. Pas vitit 2001, këto ndryshime janë evidente, të cilat reflektohen dhe në Fletoret Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Në Fletoren Zyrtare<sup>17</sup> këto ndryshime janë pasqyruar dhe në fushën e prodhimit dhe trafikimit të narkotikëve. Në nenin 64 të saj<sup>18</sup> është bërë një shtojcë në lidhje me trafikimin e narkotikëve. Siç shikohet dhe nga ndryshimet e bëra dhe në raport me Kodin Penal të Azhornuar, tentohet drejt masave të reja shtrënguese në lidhje me trafikimin e narkotikëve. Neni 65 i pasqyruar në Fletoren Zyrtare<sup>19</sup> ka një paragraf që i shtohet nenit 283/a, ku flitet për krijimin e lehtësirave për marrjen dhe përdorimin e drogës. Kjo shtojcë tregon për shkallëzimin e masave të dënimit që merren dhe ndaj personave, që për shkak të detyrës i disponojnë ato duke krijuar një hapësirë më të madhe në luftën kundër trafikut të narkotikëve. Po kështu në nenin 66 të pasqyruar në këtë fletore ka ndryshime të paragrafëve të caktuar të nenit 284 të Kodit Penal të Azhornuar:<sup>20</sup>

Këto ndryshime pasqyrojnë forcimin e ligjit ndaj kultivuesve të bimëve narkotike duke rritur njëkohësisht dhe masën e dënimit të tyre. Neni 284/b i Kodit Penal (të azhornuar), i cili trajton ndihmën në zbulimin e narkotikëve, i shtohen dhe dy nene të tjera 284/c dhe

---

karakteristikave të kriminalitetit, kuptimin e organizatës kriminale dhe strukturën e saj, autori e ka pasqyruar dhe në artikullin e botuar për këtë problem. Veçanërisht interes paraqet forma e organizimit të krimit të organizuar që ka të bëjë me fushën e kontrabandës, me trafikun e bimëve narkotike dhe të drogës, si dhe me trafikun e prostitucionit.

<sup>17</sup> Fletorja Zyrtare Nr.4, Shkurt 2001.

<sup>18</sup> Fl.Zyrt. neni 283/a: “Importimi, eksportimi, tranzitimi dhe tregtimi në kundërshtim me ligjin i substancave psikotrope si dhe i farërave të bimëve narkotike, dënohet me burgim nga 7 gjer në 15 vjet. Po kjo veprë kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet. Organizimi, drejtimi ose financimi i kësaj veprimtarie dënohen me burgim nga 10 gjer në 20 vjet. Organizimi, drejtimi ose financimi i kësaj veprimtarie dënohen me burgim jo më pak se 15 vjet”.

<sup>19</sup> Fletorja Zyrtare Nr.4, neni 65: “Krijimi nga ana e personave, që për shkak të detyrës administrojnë substanca narkotike ose psikotrope, i lehtësirave për marrjen dhe përdorimin e këtyre substancave, në kundërshtim me dispozitat ligjore përkatëse, dënohet nga tre gjer në shtatë vjet”.

<sup>20</sup> Fl.Zyrt. Nr.4, neni 66: “Kultivimi i bimëve që shërbejnë ose dihet që shërbejnë për prodhimin dhe nxjerrjen e lëndëve narkotike dhe psikotrope pa leje dhe autorizim sipas ligjit dënohet me burgim nga tre gjer në shtatë vjet”. Gjithashtu dallojmë një shtesë në nen dhe rritje të masës së dënimit: “Po kjo veprë, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet”.

Dënimi i personave që merren me organizimin, drejtimin apo financimin e kësaj veprimtarie – “nga pesë gjer në dhjetë vjet, të pasqyruara në Kodin Penal (të azhornuar), rritet nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet”.

284/d, të pasqyruara në nenin 67 të Fletores Zyrtare me Nr.4 të vitit 2001. Neni 284/c<sup>21</sup> trajton prodhimin dhe fabrikimin e lëndëve narkotike dhe psikotrope. Kjo shtojcë kufizon në një masë të konsiderueshme dhe kategorinë e personave të licencuar për prodhimin e lëndëve narkotike. Në rastin kur dhe ato kryejnë veprime jashtë kuadrit ligjor, do t'i nënshtrohen ndjekjes dhe dënimit penal, gjë e cila nuk ka qenë e parashikuar më parë në Kodin penal. Kjo është një tjetër masë ligjore që ndërmerret në luftën ndaj trafikut të narkotikëve, duke prekur dhe atë kategori të personave të licencuar që mund të synojnë trafikimin e narkotikëve.

Neni 284/c i pasqyruar në Fletoren Zyrtare Nr.4, na njeh me masat ndëshkuese ndaj prodhimit, tregtimit dhe përdorimit të paligjshëm të prekursorëve.<sup>22</sup> Nëpërmjet këtij neni, që i shtohet nenit ekzistues të Kodit Penal të Azhornuar, synohet të forcohet lufta e krimit ndaj narkotikëve duke iu nënshtuar ndjekjes dhe dënimit penal të gjithë personat që jo vetëm prodhojnë dhe tregtojnë por, madje dhe mbajnë në mënyrë të paligjshme prekursorë në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Si dhe shtojca të tjera, *synohet të ngushtohet sfera e veprimit të paligjshëm në fushën e narkotikëve duke rritur masën e dënimit në rastin kur vepra penale kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë*. Rritja e masës së dënimit merret ndaj gjithë personave që mbajnë, prodhojnë dhe transportojnë substanca kimike. Kjo vihet re dhe në ndryshimet që i janë bërë nenit 285 të Kodit Penal të Azhornuar, të cilat pasqyrohen në nenin 68 të Fletores Zyrtare me Nr.4 të vitit 2001.<sup>23</sup> Ndryshime përmban dhe neni 286 (nëpërmjet dy neneve shtojcë) që trajton problemin e nxitjes për përdorimin e drogës. Në nenin 69 të Fletores Zyrtare përmbajtja e nenit shtojcë 285/a konsiston në përshtatjen e lokalit për përdorim droge.<sup>24</sup>

<sup>21</sup> Fl.Zyrt.Nr.4, Neni 284/c: “Prodhimi, fabrikimi, nxjerrja, rafinimi, përgatitja pa licensë ose në kapërcim të përmbajtjes së tij i lëndëve narkotike dhe psikotrope, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet. Po kjo veprë, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet. Organizimi, drejtimi ose financimi i kësaj veprimtarie dënohen me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet”.

<sup>22</sup> Fl.Zyrt. Nr.4, (K.P.A:114).Neni 284/c: “Prodhimi, importimi, eksportimi, tranzitimi, tregtimi dhe mbajtja, në kundërshtim me dispozitat përkatëse ligjore, i prekursorëve të treguar me ligj në tabelat përkatëse, dënohet me burgim gjer në pesë vjet». Po kjo veprë, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga tre gjer në shtatë vjet. Organizimi, drejtimi dhe financimi i kësaj veprimtarie dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet”.

<sup>23</sup> Fl.Zyrt. Nr.4, (K.P.A:114). Neni 285: “Prodhimi, mbajtja, transportimi ose shpërndarja e substancave kimike bazë ose e substancave të tjera të çfarëdollojshme, e pajisjeve, e materialeve, në rast se dihet se ato përdoren ose do të përdoren për prodhimin ose trafikimin e paligjshëm të substancave narkotike a psikotrope, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet”. (:114).

<sup>24</sup> F.Zyrt. Nr.4, (K.P.A:114), Neni 286: “Përshtatja ose lejimi për përshtatjen e lokalit, banesës, mjeteve motorike dhe të çdo mjeti tjetër publik ose privat për grumbullimin e personave me qëllim që ata të konsumojnë substanca narkotike ose psikotrope, dënohet me burgim gjer në pesë vjet”.

Siç shihet masat shtrënguese dhe ndjekja penale përfshijnë dhe individë që synojnë përshtatjen e banesave, lokaleve përfshirë dhe mjetet motorike për qëllime trafikimi të narkotikëve, madje dënim me gjobë dhe burgim është parashikuar ndaj personave që hedhin dhe braktisin shiringa, të cilat janë parashikuar në nenin 285/b.<sup>25</sup> Po kështu, ndryshimet që pëson neni 286 në paragrafët e tij<sup>26</sup> synojnë të parandalojnë dhënien dhe infektimin e lëndëve narkotike personave që nuk kanë dijeni apo nuk pëlqejnë përdorimin e tyre, ku parashikohet dhe masa e dënimit penal ndaj tyre.

Në nenin 71 të Fletores Zyrtare pëson ndryshime neni 286 i Kodit Penal duke iu shtuar neni 286/a, *i cili trajton përdorimin e paligjshëm të teknologjisë së lartë, ku jepen dhe dënime penale për personat që transmetojnë dhe përhapin njoftime publicitare për të stimuluar marrjen e narkotikëve.*<sup>27</sup> Ky nen synon të parandalojë përhapjen në masë të përdoruesve të lëndëve narkotike duke parashikuar për to dhe dënimet penale përkatëse. Rritja e masës së dënimit është parashikuar dhe për personat që kryejnë veprime financiare me qëllim pastrimin e parave si dhe për ata që këtë vepër penale e kryejnë në bashkëpunim ose më shumë se një herë. Pikërisht shtojca që i bashkëngjitet nenit 287 (287/a) na njeh me këtë rast.<sup>28</sup>

### **5. Legjislacion tjetër në fushën e parandalimit dhe në luftën ndaj trafikut të substancave narkotike**

Mbas vitit 2001 dallojmë një sërë masash ligjore të marra në fushën e trafikimit të substancave narkotike. Me dekretin Nr.2963, datë 9.04.2001, të Presidentit të Republikës shpallet ligji “Për parandalimin dhe luftën ndaj trafikut të substancave narkotike ose

<sup>25</sup> Fl.Zyrt. Nr.4, Neni 285/b: “Hedhja e shiringave ose braktisja e shiringave, në vende publike ose të hapura për publikun, si dhe në mjedise private të përdorimit të përbashkët të shiringave ose instrumenteve të rrezikshme, të përdorura për marrjen e substancave narkotike ose psikotrope, përbën kundravajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer një vit”.

<sup>26</sup> Fl.Zyrt. Nr.4, Neni 286: “Nxitja e të tjerëve për përdorimin e lëndëve narkotike dhe psikotrope dhe dhënia në përdorim ose injektimi i tyre te të tjerët, pa dijeninë dhe pëlqimin e tyre, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet”. Në paragrafin e dytë pa asnjë ekuivok, parashikohet që “masa e dënimit për ata që nxisin dhe injektojnë drogën tek fëmijët apo në institucione shkollore të mos jetë më pak se dhjetë vjet”.

<sup>27</sup> Fl.Zyrt.Nr.4, “Prodhimi dhe përdorimi i sistemeve telematike, mjeteve dhe pajisjeve të teknologjisë së lartë, në rastet e veprave penale të parashikuara në nenet 283 gjer 286/a të këtij Kodi ose për të mundësuar ose lehtësuar konsumimin e lëndëve narkotike dhe psikotrope ose për të transmetuar dhe përhapur njoftime publicitare për stimulimin e përdorimit të tyre, dënohet me burgim gjer në pesë vjet”.

<sup>28</sup> Fl.Zyrt. Nr.4, “Kryerja e veprimeve financiare ose e veprimeve të tjera ekonomike me qëllim pastrimin e parave, që dihet se rrjedhin nga veprimtari kriminale, si dhe rivënien në qarkullim dhe përdorimin e tyre për veprimtari sipërmarrëse ose ekonomike të çdo lloji, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet. Po kjo vepër kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe, kur ka sjellë pasojat të rënda, me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet”.



psikotrope”.<sup>29</sup> Në të pasqyrohet 32 nene që përcaktojnë normat për parandalimin dhe luftën ndaj trafikut të substancave narkotike përdorimit të paligjshëm të substancave kimike bazë, si dhe të prekursorëve që përdoren për prodhimin e tyre. Po kështu, jepen një sërë përkufizimesh në lidhje me terminologjinë specifike për fushën, që kanë të bëjnë me terma të tilla si: “blerje e stimuluar”, “dorëzim i kontrolluar”, “kultivim”, “prekursor”, “punonjës i policisë i infiltruar”, “punonjës i policisë nën mbulim”, “substancë narkotike ose psikotrope”, “trafik i paligjshëm”. Gjithashtu përcaktohen qartë substancat që bëjnë pjesë në lëndët narkotike të pasqyruara në një tabelë përkatëse. Nëpërmjet terminologjisë së dhënë dhe të përcaktuar me ligj, synohet që me këto terma të operohet në këtë fushë nga të gjitha organet përkatëse si dhe nga Komiteti Kombëtar i bashkërendimit të luftës kundër drogës, në përbërje të të cilit hyjnë pothuajse të gjitha ministratë, si dhe Prokurori i Përgjithshëm dhe Kryetari i Shërbimit Informativ Shtetëror. Detyrat e këtij komiteti janë të përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji. Qëllimi kryesor i ngritjes së këtij komiteti ka të bëjë me përcaktimet e drejtimeve të politikës së përgjithshme në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar të parandalimit dhe të luftës kundër prodhimit e përhapjes së paligjshme të substancave narkotike duke promovuar fushata për të bërë të njohura efektet negative të drogës, masat e parandalimit, asistencën shëndetësore dhe të dhënat epidemiologjike dhe statistikore, rehabilitimin dhe integrimin e toksikodipendentëve.

Organizimi i një rrjeti të tërë shtetëror me qëllim marrjen e masave parandaluese, si dhe depërtimin në një shtrat sa më të thellë të luftës kundër drogës duket dhe në krijimin e Zyrës së Sistemit Kombëtar të të Dhënave për Drogën e ngritur pranë Këshillit të Ministrave që pasqyrohet në nenin 4 të këtij ligji. Detyrimet e këtij organizimi përfshijnë përpunimin e një sërë analizave, që kanë të bëjnë me përbërjen e popullsisë që përdor drogën; me zonat e kultivimit dhe burimet e trafikimit; me veprimtaritë e kryera dhe rezultatet e arritura nga forcat e policisë; me numrin dhe përfundimin e proceseve penale për krimet në fushën e drogës; me numrin e personave të denoncuar për krime në këtë fushë; me vendndodhjen dhe funksionimin e shërbimeve publike që veprojnë në sektorin e rehabilitimit të personave përdorues të drogës; me numrin e subjekteve juridike dhe fizike të autorizuara për prodhimin, shitjen dhe importimin e substancave narkotike si dhe me nismat e ndërmarra nga nivele të ndryshme institucionale në fushën e të dhënave për parandalimin dhe riaftësimin e përdoruesve të drogës (neni 5:393). Në këtë ligj vëmendje e veçantë i kushtohet dhe shërbimit të luftës kundër drogës, ku përcaktohen qartë organizmat gjyqësore që bashkëpunojnë punën midis tyre në luftën dhe trafikimin e substancave narkotike, duke e shtrirë veprimtarinë e tyre dhe në nivel ndërkombëtar, në mbajtjen e lidhjeve të drejtpërdrejta me shërbimet simotra të policive të vendeve të tjera dhe me zyrën e Interpolit (nenet 6-12 :394).

<sup>29</sup> Ligji nr. 8750 dt. 26.03.2001 “Për parandalimin dhe luftën ndaj trafikut dhe substancave narkotike dhe psikotrope”.

Në nenet 13-15 të këtij ligji, përcaktohen dhe metodat siç janë ato të «blerjes së stimuluar» apo “dorëzimit të kontrolluar”, të cilat përdoren nga shërbimi i luftës kundër drogës me qëllim grumbullimin e provave, identifikimin dhe arrestimin e personave të përfshirë në trafikun e drogave. Po kështu, dhe për përdoruesit e mjeteve të transportit, nën veprimin e përdorimit të substancave narkotike ose psikotrope merren masa të ndjekjes penale, ku ata sipas rastit, dënohen me gjobë ose me burgim deri në dy vjet (neni 19 :395). Në ligj parashikohet dhe hetimi mbi të ardhurat e çdo personi, kur ka të dhëna që vërtetojnë se pasuria e tij është me prejardhje nga kryerja e veprave penale në fushën e drogës (neni 21).

Shteti merr nën mbrojtje të gjithë personat që u kërcënohet jeta, familja apo prona si rezultat i bashkëpunimit të tyre të hapur apo të fshehur me organet përkatëse (neni 24) dhe në rastet kur personi bëhet i paaftë për të punuar ose vritet për shkak të këtij bashkëpunimi i sigurohet familjes ndihmë financiare e menjëhershme (neni 25). Të dhënat që lidhen me identitetin ose punën që ka bërë personi, i cili bashkëpunon ose ka bashkëpunuar në mënyrë të fshehtë me shërbimet e luftës kundër drogës, përbëjnë sekret (neni 26).

Të gjitha këto masa të sanksionuara me ligj synojnë afrimin e një numri sa më të madh njerëzish për të stabilizuar dhe për të marrë pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë në luftën kundër drogës, duke krijuar një rrjet sa më të dendur për të minimizuar penetrimin në të të autorëve të trafikut të drogës duke shmangur në të njëjtën kohë sa më shumë të jetë e mundur numrin e viktimave në këtë fushë. Në nenet 28 dhe 29 përcaktohen edhe masat që duhen marrë për asgjësimin e substancave narkotike ose psikotrope të sekuestruara duke hartuar rregullore të veçanta për ruajtjen, administrimin dhe përdorimin e teknikave të asgjësimit të tyre, ku mostrat e nevojshme të këtyre substancave mund të përdoren nga Ministria e Shëndetësisë për arsye studimore dhe shkencore.

## 6. Përfundime

Përmirësimi i politikës penale në këtë fushë mund të njohë ndryshime të mundshme që mund të përkojnë me:

- Një bashkëveprim më të ngushtë dhe cilësor të organizmave të specializuar (prokurori, gjykatë, polici), pasi nga statistikat, rezulton një numër shumë herë më i madh i personave që merren me trafikimin e lëndëve narkotike i evidentuar nga organet e policisë në krahasim me personat e gjykuar.
- Në këtë kuadër, koordinimi i punës së organizmave të përfshira në këtë luftë, do të kishte efektshmëri më të madhe në qoftë se vëmendja do të përqendrohej në

pakësimin e numrit të procedimeve të pezulluara, në rritjen e numrit të rasteve të dërguara në gjykatë si dhe në ndjekjen e një politike më të ashpër dënimi ndaj autorëve të krimit.

- Krijimi i mundësive për ri-integrimin e viktimave nëpërmjet ristrukturimit të të gjitha institucioneve të vuajtjes së dënimit duke i kthyer ato në qendra tipike rehabilitimi.
- Hartimi i strategjive komplekse duke u bazuar jo vetëm në legjislacionin e vendeve më të zhvilluara, por duke pasur parasysh dhe vetë kushtet specifike të zhvillimit të vendit si dhe pozicionin e tij si urë lidhëse e krimit të organizuar në rajon e më gjerë.

## **BIBLIOGRAFI**

Sula. Z, “Droga dhe të rinjtë”, 1999.

Vendim i qeverisë nr. 412, datë 20 maj 1996.

Kodi i Ri Penal 1995.

Kodi Penal i Azhornuar 1999.

Kodi i Procedurës Penale.

Elezi. I; Haxhia. M; Kaçupi. S; “Komentari i Kodit Penal – Pjesa e përgjithshme”.

Bejko. Sh. “Analizë juridiko-penale e krimit të organizuar”.

Fletore Zyrtare nr. 4, 2001.

Ligji Nr. 8750 dt. 26.03.2001 “Për parandalimin dhe luftën ndaj trafikut dhe substancave narkotike dhe psikotrope”.